KRONIKË E ZEZË

Një person arrestohet në flagrancë për grabitje në Ferizaj



Foto ilustrim

13 shkurt 2023, 11:51

Shpërndaje në

Një person i dyshuar për grabitje është arrestuar të hënën në Bibaj të Ferizajt, ka njoftuar Policia.

Sipas njoftimit, një 61-vjeçar e ka informuar policinë rreth orës 02:20 se disa persona të maskuar ishin duke vjedhur në shtëpinë e tij.

"Me të arritur te shtëpia, patrulla kanë vërejtur se të dyshuarit ishin brenda shtëpisë dhe në përpjekje për t'i kapur në flagrancë të dyshuarit kanë kërcyer nga kati i dytë, duke u larguar nga oborri në fushë të hapur në drejtime të ndryshme. Pas ndjekjes së tyre policia ka arritur që të ndalojë njërin të dyshuar dhe më pas ta arrestojë, i cili duke rezistuar kishte sulmuar zyrtarët policorë", thuhet në njoftim.

Si dëshmi, tek i dyshuari janë gjetur stoli ari, një thikë dhe bateri ndriçuese, ndërsa tre persona të tjerë janë larguar në drejtim të panjohur.

"Policët hetues dhe krimteknikët e Sektorit Rajonal të Hetimeve i kanë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe nën autorizim të prokurorit kujdestar nga ProkuroriaThemelore në Ferizaj i kanë nisur hetimet", bën të ditur më tej Policia.

Nga hetimet e para thuhet se është mësuar që katër persona me maska kishin depërtuar me forcë brenda në shtëpi dhe sipas viktimës 34-vjeçare, e cila ishte në gjumë me katër fëmijët e saj, posa kishte dëgjuar zhurmën arrin përmes telefonit që ta njoftojë vjehrrin e saj, e që më pas ai njofton policinë, ndërsa viktima has të maskuarit, të cilët ishin me armë zjarri në dorë.

"Të dyshuarit në prezencë të saj dhe fëmijëve, nën kërcënimin e armëve kanë grabitur stoli ari dhe gjësende të tjera në vlerë rreth 20 mijë eurove. I dyshuari/i arrestuari në flagrancë I.R, mashkull, shqiptar, shtetas i Serbisë, i moshës 48 vjeçar është shoqëruar në Sektorin Rajonal të Hetimeve në Ferizaj për procedura të intervistimit, verifikimit dhe hetimit dhe me vendim të prokurorit të rastit dërgohet në mbajtje për 48 orë, ndërsa në kërkim policor mbeten të dyshuarit tjerë të kësaj ngjarje", thuhet tutje në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

#ARRESTIM #VJEDHJE #FERIZAJ

Kosovarja në Zvicër dënohet me 14 vjet burgim, tentoi ta vriste bashkëshortin me kabillo
Publikohen pamjet kur hoteli në Sarandë hidhet në erë
Policia identifikon disa lëmoshkërkues në Skenderaj, iu shqipton fletëparaqitje
Gjenden mbetje mortore në Gjakovë
Shtyhet gjykimi ndaj Agim Ademit
Shtetasi turk arrestohet në Aeroportin e Prishtinës, tentoi të udhëtonte me dokument të falsifikuar
Një grua raporton në Polici se është dhunuar, arrestohet i dyshuari

YouTube
Privacy

TaboolaFeed

Kolltuk masazhues profesional - 73% zbritje! Vetëm 55 000 Lek
megadorfja.al | Sponsored

Villas Prices In Dubai Might Be More Affordable Than You Think
Dubai Villas | Search Ads | Sponsored

Shtetasi turk arrestohet në Aeroportin e Prishtinës, tentoi të udhëtonte me dokument të falsifikuar
Një shtetas turk është arrestuar të dielën në Aeroportin e Prishtinës "Adem Jashari". Sipas njoftimit të Policisë, ai është arrestuar nën dyshimin se ka tentuar të udhëtojë me dokument…
Kohanet



Interested In Artificial Intelligence? Courses In Albania Might Surprise You
Artificial Intelligence Course | Search Ad | Sponsored

Do You Speak English? Work For a US Company, Live in Albania
US Jobs | Search Ads | Sponsored

Want to Spend More Time with Family? an AI Course Might Offer Y…
AI Courses | Search Ads | Sponsored



Një grua raporton në Polici se është dhunuar, arrestohet i dyshuari
Një grua raporton në Policinë e Kosovës të dielën se është dhunuar nga një i dyshuar. Sipas Policisë, rasti ka ndodhur në Ferizaj, ku i dyshuari është arrestuar dhe pas intervistimit, me …
Kohanet

The Prices of an Artificial Intelligence Course Might Surprise You
AI courses | Search | Sponsored

TË TJERA

Hidhet në erë me tritol një hotel në Sarandë

Arrestohen dy persona për dhunë ndaj familje në Ferizaj e Shtime

Fushë-Kosovë, arrestohen dy persona që dyshohet se theren për vdekje një 41-vjeçar

Theret për vdekje një person në Fushë-Kosovë

Kjo faqe kontrollohet dhe mbrojtur nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i pasaktësuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, Kohavision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha shkeleset e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.